


ARCHIVES
PORTALEUROPE



ARCHIVES
PORTALEUROPE

ARCHIVESPORTALEUROPE.NET

 @ArchivesPortal

 archivesportaleurope

 Archives portal europe

THE HISTORY OF EUROPE - JUST ONE CLICK AWAY.

Mirë se vini në Portalin e Arkivave të Evropës

Portali i Arkivave të Evropës është vendruarja më e madhe arkivore online në botë, një shërbim digjital që u mundëson përdoruesve të kërkojnë falas në kujtesën e Evropës.

Portali i Arkivave të Evropës përdor teknologjitë digjitale për t'u bërë hallka që mungon midis studiuesve dhe trashëgimisë arkivore Evropiane. Aktualisht ai ofron akses në më shumë se 295 milionë të dhëna, që u përkasin qindra arkivave evropiane në 37 vende (dhe numri vazhdon të rritet) – nga Malta në Norvegji, nga Portugalia në Gjeorgji. Të gjitha në një Portal të vetëm!

Informacioni i disponueshme në Portalin e Arkivave të Evropës po zgjerohet vazhdimisht dhe të dhëna të reja hidhen pothuajse çdo ditë.

Portali i Arkivave të Evropës menaxhohet nga Archives Portal Europe Foundation (APEF), një shoqatë jofitimprurëse që garanton hapjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të Portalit, duke promovuar njëkohësisht shkëmbimin e njohurive ndërmjet profesionistëve të arkivave në Evropë dhe më gjerë.

Lietuvos centrinis valstybės archyvas, Miestų herbų pavyzdžiai; Lietuvos valstybės istorijos archyvas, Fragmentas iš psalmių



Një platformë e vetme për të gjitha arkivat

Portali i Arkivave të Evropës është një platformë publike e hapur për çdo institucion, kudo në botë, që dëshiron të ndajë të dhënat e tij arkivore në lidhje me historinë evropiane.

Portali funksionon mbi standarde ndërkombëtare të metadata arkivore, të cilat garantojnë që përmbajtja e Portalit të jetë e aksesueshme në mënyrë të qëndrueshme, pavarësisht nga vendi i origjinës.

Portali i Arkivave të Evropës mirëpret vazhdimisht institucione të reja për t'u bashkuar rrjetit dhe për t'u bërë ofrues të përmbajtjes të informacionit – një shërbim plotësisht falas. Lidhja me Portalin e Arkivave të Evropës do të thotë t'i bashkoheh rrjetit më të madh ekzistues të profesionistëve evropianë të arkivave, të cilët kontribuojnë për të siguruar të ardhmen digjitale të trashëgimisë arkivore.

Një mjet unik kërkimor

Me ritmin në rritje prej disa milionë njësish të reja përkushtues çdo vit, Portali i Arkivave të Evropës është një mjet i domosdoshëm për çdo studiues që ka nevojë të konsultojë burime parësore mbi historinë e Evropës.

Me vetëm një klikim, është e mundur të arrihet informacion mbi historinë e Evropës, nga institucionet më të mëdha kombëtare deri te arkivat më të vogla të fshatrave, arkivat famullitare, arkivat universitare dhe shumë më tepër.

Portali mundëson kërkim shumëgjuhësh dhe bën të mundur ruajtjen e dokumentave interesante dhe shpërndarjen dhe përditësimin mbi gjetjet tek grupet e kërkuesve.

